



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË
AGJENCIA KONBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA TEKNIKE ELEKTRIKE "GJERGJ CANCO"



QËNDRIMI DHE LËVIZJA NË SHKOLLË

(Rregullorja dhe protokoli i sigurisë në kuadër të masave të marra
Covid-19)

Maj, 2020

PËRMBAJTJA

I. LEGJISLACIONI.....	3
II. PJESEMARRËSIT NË HARTIMIN TË RREGULLORES.....	3
III.GRUPET E PUNËS NË ZBATIM.....	4
1. Monitorimi.....	4
2. Matja e temperaturës dhe kujdesi ndaj shëndetit të nxënësve në shkollë.....	4
3. Përgatitja e materialeve ndërgjegjësuere për zbatimin e rregullores.....	4
4. Ndërgjegjësimi për zbatimin e rregullores nga nxënësit dhe prindërit.....	4
IV. HYRJA DHE DALJA NGA AMBIENTET E SHKOLLËS, HARTA E SHKOLLËS.....	5
TABELA ME SALLAT PËR MATURANTËT, RADHA E HYRJES DHE DALJES NGA SHKOLLA KATI PËRDHE, KATI I, KATI II,	7
1. RUANI DISTANCËN.....	5
2. QËNDRIMI DHE MËSIMI NË KLASA.....	10
3. LËVIZJET NË MJEDISËT E BRENDSHME TË SHKOLLËS.....	10
4. KUJDESI PËR SHËNDETIN E NXËNËSVE DHE STAFIT NË SHKOLLË.....	11
5. NDËRGJEGJËSIMI DHE PARANDALIMI I PROBLEMEVE.....	11
V. RREGULLORE PËR STAFIN E SHKOLLËS DHE PRINDËRIT.....	12
Mësuesi.....	12
Psikologia.....	13
Mjekja e shkollës.....	14
PËR PERSONELIN NDIHMËS.....	14
Sanitaret.....	14
Rojet e Institucionit Arsimor.....	15
PËR PRINDIN.....	15
PËR DREJTUESIT.....	15
TË TJERA.....	16

I. LEGJISLACIONI

Bazuar në:

- Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”;
- Urdhrin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimit Parauniversitar (ASCAP) nr. 45, datë 29.04.2020, “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, për klasën XII” ;
- Udhëzimi i AKPA dhe MFE nr. 18, datë 08.05.2020, “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve, provimet për fundimtare dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020 në shkollat profesionale publike dhe jopublike, në kushtet e gjendjes së fatkeqesisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e covid-19.
- Urdhrin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar “Plan masash për rifillimin e shkollës në klasën e XII”, Nr.1120, date 06.05.2020
- Urdhrin e MASR-së, nr.591, datë 09.03.2020, “Për ndërprejen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”, i ndryshuar, ;
- Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit shkaktuar nga COVID-19”;
- Urdhrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 289, datë 4.05.2020, Për miratimin e udhëzuesit “Për masat ndaj COVID-19 që duhet të ndërmerren institucionet arsimore” ;
- Plan masash për Institucionet e Arsimit të Mesëm të Lartë, MASR, DPAP, Nr.1120, datë 06.05.2020 “Për organizimin e mësimit, vlerësimin e nxënësve dhe mbylljen e vitit shkollor 2019-2020” (Klasa e XII)
- Rregullorja e Brendshme e Shkollës 2019-2020;
- Rregullorja për Sigurinë e Shkollës 2019-2020;
- Kodi i etikës së mësuesit.

II. PJESËMARRËSIT NË HARTIMIN TË RREGULLORES

- | | |
|---------------------|--|
| • Hedië GJONI | Kryetare/Drejtoare |
| • Elida MESI | Anëtare / NJZH |
| • Flamur MEHTETI | Anëtare/ Zv/Drejtoare/ Kryetare e Komisionit të Sigurisë, shëndetit në shkollë |
| • Dritan MEZINI | Anëtar/Kryetari i Bordit të shkollës |
| • Armanda HASA | Anëtare/Përfaqësuese e këshillit të prindërve |
| • Santiago ULNDREAJ | Anëtare/President i shkollës |
| • Adelina KOVACI | Anëtare/ Mjekja e shkollës |
| • Enxhi DEDA | Anëtare/ Psikologjia e shkollës |

III. GRUPET E PUNËS NË ZBATIM

1. Monitorimi

- Flamur MEHMETI **Zv/Drejtores (monitoron oborrin e shkollës dhe katin përdhe të shkollës ; zbatimin e kësaj rregulloreje)**
- Jorgo KOKA **Zv/Drejtores (monitoron katin e parë dhe të dytë të shkollës ; zbatimin e kësaj rregulloreje)**
- Soni DUKA (oborri), Nilson IBRAJ, Devis MERDINI (kati përdhe), Erjon GJINO, Abaz SHEHU (kati I), Lumturie MARKU Majlinda HAXHI **Mësuesit përgjegjës katesh dhe oborrin e shkollës, për dezhurnin në shkollë**

2. Matja e temperaturës dhe kujdesi ndaj shëndetit të nxënësve në shkollë

- Adelina KOVACI **Mjeke e shkollës/kryetare e stafit mjekësor**
- Enxhi DEDA **Psikologe e shkollës**

3. Përgatitja e materialeve ndërgjegjësuere për zbatimin e rregullores

- Flamur MEHMETI **Zv/Drejtor Kryetar i Komisionit të Sigurisë dhe Shëndetit**
- Enxhi DEDA **Anëtare/ Psikologe**
- Adelina KOVACI **Anëtare/ Mjeke**
- Anila Papa **Anëtare/ Financiere**

4. Ndërgjegjësimi për zbatimin e rregullores nga nxënësit dhe prindërit

- Ilda SHAHU **Mësuese kujdestare, Klasa 13¹**
- Nertila META **Mësuese kujdestare, Klasa 13²**
- Valentina QELIA **Mësuese kujdestare, Klasa 13³**
- Loreta POLAJ **Mësuese kujdestare, Klasa 13⁴**
- Majlinda HAXHI **Mësuese kujdestare, Klasa 13⁵**
- Devis MERDINI **Mësues kujdestar, Klasa 13⁶**
- Elida MESI **Mësuese kujdestare, Klasa 13⁷**

IV. PROTOKOLLI I SIGURISË PËR NXËNËSIT DHE STAFIN

1. HYRJA DHE DALJA NGA AMBIENTET E SHKOLLËS



1. Nxënësit paraqiten në shkollë në orarin e përcaktuar.
 2. Hyjnë një nga një në shkollë sipas drejtimit të përcaktuar, me anë të sinjalistikës, së vendosur në oborr, koridore dhe klasa.
 3. Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose atë të familjes, verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo.
 4. Justifikimi i mungesës bëhet vetëm nga mjeku i familjes.
 5. Personeli mjekësor i shkollës (mjekja, ndihmës mjekja dhe stomatologia e shkollës), i caktuar nga drejtori, duhet të kryejë vlerësimin për nxënësin si më poshtë:
 - a. Matje të temperaturës me termometër digjital;
 - b. Sprucimi me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar;
 - c. Duhet të kontrollohen të gjithë nxënësit që të jenë të pajisur me maskë një përdorimshme ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhen të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjenën e hundëve;
 6. Përpara hyrjes në ambientet e brëndshme të shkollës, do të vendosen vaska me solucion dezinfektues me bazë të klorit aktiv, për dezinfektimin e shuajve të këpucëve;
 7. Nxënësit e Katit të parë do të ndjekin tabelën si më poshtë dhe drejtimin: Në hyrje të portës, ndiqni drejtimin e djathë deri në hyrje të godinës, më pas shkoni në sallën ku keni emrin. Mësoni paraprakisht ku ndodhet salla juaj, duke u orintuar me ambient si më poshtë.
- Shigjetat tregojnë drejtimin e lëvizjes tuaj, por nuk lejohet vajtja nëpër klasa apo

kate të tjera. Cdo lëvizje do të jetë vetëm me leje dhe e konfirmuar nga përgjegjësi i katit.

8. Nuk lejohet që nxënësit të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës.
9. Porta e jashtme e shkollës do të qëndrojë e mbyllur gjatë procesit mësimor.
10. Nuk lejohet të hyjë asnjë person tjetër që nuk është pjesë e shkollës, pa marrë më parë konfirmim nga drejtorja e shkollës.


TABELA ME SALLAT PËR MATURANTËT, RADHA E HYRJES DHE DALJES NGA SHKOLLA

KATI	KLASAT FIZIKE	SALLA PËR MATURANTËT	KAHU I LËVIZJES	RADHA E HYRJES	RADHA E DALJES
Kati përdhe	13 ⁷ /13/7-a	Salla nr.1	Djathtas	1	1
Kati përdhe	13 ⁶ /13/6-a	Salla nr.2	Djathtas	2	2
Kati përdhe	12 ⁷ /13/6-b	Salla nr.3	Djathtas	3	3
Kati përdhe	12 ⁶ /13/6-c	Salla nr.4	Djathtas	1	1
Kati përdhe	11 ¹ /13/7-b	Salla nr.5	Majtas	2	2
Kati përdhe	11 ² /13/7-c	Salla nr.6	Majtas	3	3
Kati përdhe	11 ³ /13/6+7	Salla nr.7	Majtas	4	4
Kati I	10 ¹ /13/1-a	Salla nr.8	Majtas	4	4
Kati I	10 ³ /13/1-b	Salla nr.9	Majtas	5	5
Kati I	10 ⁴ /13/2-a	Salla nr.10	Majtas	6	6
Kati I	10 ⁵ /13/3-a	Salla nr.11	Majtas	7	7
Kati I	10 ⁶ /13/4-a	Salla nr.12	Majtas	8	8
Kati I	10 ⁷ /13/4-b	Salla nr.13	Majtas	9	9
Kati I	11 ⁶ /13/5-a	Salla nr.14	Djathtas	10	10
Kati I	11 ⁷ /13/5-b	Salla nr.15	Djathtas	11	11
Kati II	13 ¹ /13/2-b	Salla nr.16	Majtas	5	5
Kati II	13 ² /13/2-c	Salla nr.17	Majtas	6	6
Kati II	13 ³ /13/3-b	Salla nr.18	Majtas	7	7
Kati II	13 ⁵ /13/5-c	Salla nr.19	Majtas	8	8
Kati II	12 ¹ /13/4-c	Salla nr.20	Majtas	9	9
Kati II	12 ² /13/3-c	Salla nr.21	Majtas	10	10


Hyrja ne shkollë




Skema e katit përdhe



Nxënësit hyjnë në të djathtë të portës së jashtme dhe nga dera kryesore të shkollës.





2. RUANI DISTANCËN

- Stafi i shkollës dhe nxënësit do të ruajnë distancimin fizik, 2 metra nga njëri-tjetri, në çdo ambient të shkollës.
- Të gjithë do të mbajnë maskën dhe asnjë person, nxënës, staf apo person jo i shkollës, nuk do të lejohet të futet apo të qëndrojë në ambientet e shkollës pa maskë.

3. QËNDRIMI DHE MËSIMI NË KLASA

- Në klasa, nxënësit hyjnë një nga një, duke ruajtur distancën 2 metra njëri-tjetri.
- Ulen në bankën e përcaktuar, sipas listës së miratuar nga drejtoria e shkollës dhe të njoftuar nga mësuesi kujdestar, para fillimit të shkollës.
- Gjatë procesit mësimor, mësuesit qëndron në klasë, duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit e tjerë (në 2 metra).
- Nxënësit nuk ndërrojnë vendet, nuk shkëmbejnë objekte, sende personale me njëri-tjetrin.
- Për çdo problem që do kenë do të komunikojnë me: mësuesin që kanë në klasë, me mësuesin kujdestar, të cilët njoftojnë përgjegjësin e katit, oficeren e sigurisë, për rastet emergjente, këta të fundit kontaktojnë me stafin drejtues të shkollës.

- Në klasë zbatohen rregullat e higjienës personale për Covid-19.
- Nuk lejohet ushqimi në klasë, përveç ujit.
- Nxënësit nuk mund të dalin nga klasa, përveç rasteve kur duhet të shkojnë në tualet, me leje.

4. LËVIZJET NË MJEDISËT E BRENDSHME TË SHKOLLËS

- Nxënësit do të hyjnë në fillim të procesit mësimor dhe do të dalin në përfundim të tij.
- Lëvizja në shkollë do të bëhet sipas hartës së kësaj rregulloreje, e cila do të jetë e afishuar në koridore, klasa.
- Nuk lejohen qëndrimet në koridore.
- Nuk lejohen lëvizjet nëpër klasat e tjera.
- Nuk lejohen lëvizjet në kate të tjera.

5. KUJDESI PËR SHËNDETIN E NXËNËSVE DHE STAFIT NË SHKOLLË

- Për çdo shtetësim me shëndetin: temperaturë, kollë, shenja të Covid 19, në kohën kur nxënësit apo anëtarë të stafit, të shkollës, do të kujdeset stafi mjekësor i shkollës: të hënë, të mërkurë, të premte, mjekja e shkollës, ndërsa të martë, të enjte, infermierja.
- Në rast emergjence do të njoftohet Urgjenca Mjekësore, në numrin 127.
- Nxënësit të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë shkollës, nëpërmjetë mesazheve sensibilizuese të shpërndara nga ekipi mjekësor dhe shërbimi psiko-social i shkollës.
- Stafi mjekësor i shkollës do të asistojë çdo ditë për këshillim dhe monitorim të zbatimit të rregullave të higjienës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes dhe tështitjes.
- Çdo nxënës në shkollë duhet të lajë duart apo dizinfektojë pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës etj.
- Gjatë qëndrimit në ambientet e shkollës, çdo individ duhet të mbajë detyrimisht maskë.
- Dritaret duhet të mbahen të hapura, ose të paktën klasat të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimt.
- Janë të ndaluara takimet dhe mbledhjet ballë për ballë në ambientet e shkollës.
- Në një klasë apo sallë laboratorit të mos qëndrojnë më shumë nxënës sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin social dhe fizik.
- Aktivitetet jashtëshkollore, sportive e artistike në grup janë të ndaluara.
- Janë të afishuara në të gjitha ambientet e shkollës postera mbi masën e parandalimit të infeksionit COVID-19, postera me mesazhe të qarta dhe të thjeshta dhe postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.

- Do të kryhet dezinfektimi i çdo klase, çdo ditë. Pas përfundimit të procesit mësimor, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese.
- Në fund të çdo dite do të kryhet denzifektimi i mjediseve të përbashkëta të shkollës.
- Do të pranohen në ambientet e shkollës vetëm nxënësit që do të firmosin rregulloren mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19.
- Përpara se të rifillojnë mësimin në ambientet e shkollës, sipas rreguloreve të reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nxënësit duhet të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID-19.
- Nëse nxënësi manifeston gjendje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të shkollës nëpërmjet mësuesit kujdestar dhe “Këndit të psikologut” online pranë DRAP-së.
- Nxënësit që nuk zbatojnë rregulloren, trajtohen me masë sipas rregullores së shkollës.

6. NDËRGJEGJËSIMI DHE PARANDALIMI I PROBLEMEVE

- Në mjediset e shkollës, në koridore, klasa, do të afishohen postera ndërgjegjësues në lidhje me kujdesin ndaj shëndetit, rregullat e higjienës që duhen zbatuar për Covid-19.
- Mjekja, infermierja, do të bëjnë ndërgjegjësime në klasa në fillim të procesit mësimor.
- Zbatimi i rregullave të distancimit social dhe lëvizjeve do të monitorohen nga oficerja e sigurisë, përgjegjësit e kateve sipas grafikut ditor.
- Nxënësit që nuk zbatojnë rregulloren trajtohen me masë sipas rregullores së shkollës.

V. RREGULLORE PËR STAFIN E SHKOLLËS DHE PRINDËRIT

Mësuesit

- Mësuesi paraqitet në shkollë orën e përcaktuar nga drejtoria, 20’ përpara ardhjes së nxënësve.
- Mësuesit e kujdestarisë ditore/javore paraqiten në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës (30’ përpara ardhjes së nxënësve).
- Stafi mjekësor i shkollës (mjekja, infermierja dhe stomatologia e shkollës), të caktuar nga drejtori dhe të trajnuar për veprimet e mëposhtëme, kryen për çdo nxënës dhe anëtar të stafit mësimor dhe ndihmës, procedurën si më poshtë:
 1. Mat temperaturën me termometër digjital.
 2. Spërkat solucionin dezinfektues me përmbajtje 70% alkool në duart e nxënësve dhe të stafit.
 3. Kontrollon nëse çdo nxënës është i pajisur me maskë.
- Mësuesi mban gjatë orarit zyrtar maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.

- Gjatë orës së mësimit, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin fizik me nxënësin.
- Informon nxënësit (deri në një ditë para fillimit të procesit mësimor në klasë) për orarin mësimor, klasën ku do të zhvillojë mësim, si dhe orën e paraqitjes dhe të largimit nga shkolla, për periudhën 18.05.2020 – 05.06.2020.
- Organizon mjedisin fizik (klasat), për zhvillimin e mësimit sipas parimit të distancës fizike dhe sipas kriterëve të përcaktuara në protokollet shëndetësore të përditësuara
- Monitoron vijueshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve që përcakton për zbatim ky plan masash.
- Komunikon me prindërit për të njoftuar ecurinë e nxënësve dhe problematika të mundshme.
- Raporton në drejtorinë e shkollës për pikat e mësipërme.
- Mësuesi largohet nga institucioni vetëm me miratimin e drejtorit të shkollës.

Psikologia

Punonjësit e shërbimit psiko – social:

- Vlerësojnë gjendjen psiko-emocionale të nxënësve gjatë rifillimit të procesit mësimor, me qëllim planifikimin dhe realizimin e shërbimeve psiko-emocionale sipas nevojave të nxënësve.

- Shpërndajnë materiale ndërgjegjësuere dhe realizojnë veprimtari parandaluese me nxënësit duke respektuar rregullat e distancimit fizik, masat e sigurisë dhe të higjienës në mjediset e shkollës dhe klasave.
- Ofrojnë këshillim individual ose në grup për nxënësit, stafet drejtuese dhe pedagogjike, duke respektuar rregullat e distancimit fizik, masat e sigurisë dhe të higjienës në mjedisin ku ofrohet shërbimi.
- Ofrojnë mbështetje për nxënësit me aftësi të kufizuara (AK) përmes këshillimit dhe shërbimeve të tjera të ofruara në mënyrë drejtpërdrejtë për/me nxënësin apo nëpërmjet prindërve dhe mësuesve.

Mjekja

- Personeli mjekësor i shkollës (mjekja, ndihmës mjekja dhe stomatologia e shkollës), i caktuar nga drejtori, duhet të kryejë vlerësimin për nxënësin si më poshtë:
 1. Matje të temperaturës me termometër digjital;
 2. Sprucimi me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar;
 3. Duhet të kontrollohen të gjithë nxënësit që të jenë të pajisur me maskë një përdorimshme ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhen të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjienën e hundëve;
- Të zhvillojnë në ditën e parë dhe në vijim aktivitete ndërgjegjësuere me nxënësit dhe stafin për Covid-19. Të shpërndajnë postera, video, material elektronike për kujdesin ndaj shëndetit gjatë kësaj periudhe.

PERSONELI NDIHMËS

Sanitaret

- Personeli ndihmës paraqitet në institucionin arsimor në orën e përcaktuar nga drejtorja e shkollës (120' përpara ardhjes së nxënësve).
- Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Korridoret pastrohen çdo dy orë.
- Tualetet pastrohen e dezinfektohen çdo 30 minuta.
- Rezervuarëve të ujit që mund të ketë shkolla, u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë.
- Doreza e çdo klase dhe mjedisi pune si dhe parmakët e shkallëve dhe vende të tjera të pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.
- Largimi nga institucioni arsimor bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.
- Kryhen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit.

Rojet e Institucionit Arsimor

- Roja i shkollës paraqitet në institucionin arsimor në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës (120' përpara ardhjes së nxënësve në shkollë).
- Roja i shkollës do të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskë, doreza dhe solucion dezinfektuese.
- Roja i shkollës nuk lejon prezencën e prindërve dhe çdo individ tjetër brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe personelit të deklaruar të institucionit arsimor).
- Roja i shkollës respekton rregullin që çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të drejtorit ose të stafit drejtues.
- Roja i shkollës, i kryen të gjitha detyrat, duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit dhe sanitaret.

PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike, tek mësuesi, apo mësuesi kujdestar, këtë rregullore.
- Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjëndjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të mësuesit kujdestar.
- Në rast nevojë për komunikim me mësuesin, apo drejtuesin, përdor vetëm komunikim elektronik.
- Në rastet e shoqërimit të fëmijës/fëmijëve në shkollë, nuk futen brenda mjedisit të shkollës për çfarëdo arsyeje që mund të paraqesë.

PËR DREJTUESIT

- Ngrenë grupe pune dhe hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standarteve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara me këtë rregullore.
- Monitorojnë pajisjen e nxënësve dhe të stafit me mjete mbrojtëse, si: maskë, doreza, xhel dezinfektues për përdorim personal(sipas mundësive).
- Mbajnë kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, struktura e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.
- Për çdo fëmijë i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj...,apo ka njoftim nga prindi, ka pasur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse prindi përkatës është i sëmurë, apo ka pasur kontakte me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

TË TJERA

- Ndalohet konsumimi i ushqimeve brenda mjediseve të shkollës nga nxënës apo punonjës të institucionit.
- Ndalohen aktivitetet jashtëshkollore, sportive dhe kulturore si dhe grumbullimet e ndryshme në shkollë.